

VENDIM
Nr.36, datë 15.4.2011

**MBI ANKIMIMIN E “CEZ SHPËRNDARJE” SHA TË VENDIMIT TË BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.31, DATË 31.3.2011 “PËR MIRATIMIN E
KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
KESH SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË “CEZ
SHPËRNDARJE” SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN
1.1.2011 – 31.12.2011”**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.4.2011, pasi shqyrtoi ankimimin e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në lidhje me kontratën e furnizimit me energji për vitin 2011 ndërmjet KESH sh.a. dhe CEZ Shpërndarje” sh.a., dhe relacionin e drejtorive teknike,

Konstatoi se:

“CEZ Shpërndarje” sh.a., me anë të këtij ankimimi, ka paraqitur në ERE të njëjtat argumente që janë diskutuar me palët për këtë çështje gjatë komunikimeve zyrtare në adresë të njëra-tjetrës, si dhe në ERE, sikurse edhe gjatë mbledhjeve të Bordit të Komisionerëve të datave 4.3.2011 dhe 31.3.2011, në të cilën përfaqësues të “CEZ shpërndarje” kanë qenë prezent. Ky ankimim nuk sjell asgjë të re dhe të panjohur nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos pranojë ankimimin e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe lënien në fuqi të vendimit nr.31, datë 31.3.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a. (furnizuesi publik me pakicë) për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë ankimuese “CEZ shpërndarje” sh.a., si dhe KESH sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj